



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice  
Departamenti për Profesionet e Lirë-Departament za Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.15/2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryes, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës ( tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga nenet 17,18 lidhur me nenet 103, 104, 109, 110, 121 dhe nenin 9 të LPP-së, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike me datën 25.08.2020, në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lirë-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesi i palës ankuese "HPI" sh.p.k., dhe përmbaruesit privat, z. mbajtjes së seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur me datën 25.08.2020, Komisioni, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet të Lirë- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-15/2020, datë 13.07.2020, dhe ankesa e palës ankuese "HPI" sh.p.k. .. të datës 07.07.2020, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbarues-Përmbaruesi Privat, . . . nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore nga nenet 17,18 lidhur me nenet 103, 104, 109, 110, 121 dhe nenin 9 të LPP-së, gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr 322/20.

## Arsyetim

Me datën 30.06.2020, përkatësisht më datën 07.07.2020 pala ankuese "HPI" sh.p.k., ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat z. [ ] si organ përmbartues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkelje disiplinore nga nenet 17,18 lidhur me nenet 103, 104, 109, 110, 121 dhe nenin 9 të LPP-së. Pala ankuese pretendon që përmbartuesi privat në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi dërgimin e shkresave, pa asnjë paralajmërim, ka bllokuar llogarinë me arsyetimin se dërgesa nuk është pranuar nga ne edhe pse i njëjti ka pasur mundësi ta sigurojë adresën përmes ARBK-së. Për pasojë, përmbartuesi, i ka pamundësuar palës ankuese paraqitjen e prapësimit në Gjykatë dhe në këtë mënyrë e në kundërshtim me nenin 9 të LPP-së ka shkelur dinjitetin e saj.

Me datën 13.07.2020, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesionet e Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komisionin propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat [ ] si organ përmbartues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga nenet 17,18 lidhur me nenet 103, 104, 109, 110, 121 dhe nenin 9 të LPP-së, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore në lëndën P. nr 322/20.

Përmbartuesi privat [ ] në përgjigjen e tij me shkrim deklaron që të gjitha veprimet e ndërmara në këtë çështje janë në pajtim me dispozitat ligjore dhe autorizimet që dalin nga ligji. Lidhur me pretendimin e debitorit-këtu palës ankuese se përmbartuesi nuk i kishte dërguar shkresat në adresën e cilën e kishte në dispozicion- bazuar në të dhënat që posedon ARBK, përmbartuesi privat deklaron se pikërisht të gjitha njoftimet i janë dërguar palës ankuese në atë adresë. Përmbartuesi shton që në shkresat e lëndës janë shënuar zyrat që përshkruajnë në hollësi veprimet e ndërmara nga përmbartuesi lidhur me pretendimin e tillë. Tufje, përmbartuesi deklaron se ishin ndërmarr veprime shpesh duke kërkuar adresën e palës ankuese në faqen zyrtare të ATK dhe regjistrim e llogarive bankare dhe në të gjitha burimet e informacioneve është shfaqur e njëjta adresë. Për më tepër, përmbartuesi i kishte dërguar shkresat e lëndës palës ankuese edhe me postë e edhe personalisht por në të dy rastet kishte rezultuar e pasuksesshme. Rrejdhimisht, përmbartuesi konform nenin 114 të LPP-së kishte bërë afishimin e shkresave të lëndës në tabelën e shpalljeve në zyrën e tij dhe lidhur me këtë është njoftuar pala ankuese. Për këto arsye, përmbartuesi deklaron se nuk qëndron pretendimi i palës ankuese se përmbartuesi, në këtë çështje përmbartimore, kishte shkelur dinjitetin e saj në ndonjë mënyrë prandaj i propozon Komisionit që të refuzoj ankesën si të pabazuar.

Me datën 25.08.2020, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet e Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore; përfaqësuesit e palës ankuese "HPI" sh.p. k., si dhe përmbartuesit privat.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesionet e Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës penale ndaj përmbartuesit privat [ ] duke theksuar se bazuar në

ankesën e parashtruar nga pala ankuese përbaruesi privat ka bërë shkelje disiplinore nga nenet 17,18 lidhur me nenet 103, 104, 109, 110, 121 dhe nenin 9 të LPP-së, sepse i njëjti me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore në lëndën P.nr 322/20, ka shkelur ligjin dhe ka tejkaluar autorizimet ligjore.

Përfaqësuesi e palës ankuese "HPI" sh.p.k., theksuan se organi përbarimor-përbaruesi privat ka treguar sjellje të njëanshme në veprimet e tij lidhur me lëndën përbarimore P. nr 322/20, duke shkelur ligjin ashtu që ka bllokuar llogarinë bankare pa asnjë paralajmërim duke iu shkaktuar mes tjerash edhe dëm material. Tutje, sipas palës ankuese, përbaruesi kishte mundësi të siguronte adresën e saktë të tyre në të dhënat të cilat janë në ARBK, kishte mundësi t'i kontaktonte ata përmes telefonit apo përmes adresës elektronike të tyre të cilën ata rregullisht e kontrollojnë.

Përbaruesi privat, deklaroi se nuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese se, organi përbarues, në ndonjë mënyrë, kishte vepruar në kundërshtim me ligjin me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore ndaj palës së ankuese. Përbaruesi, thekson që, përkundrazi, përbaruesi kishte pasur konsideratë në kërkesat e palës ankuese, i kishte zbritur shuma të caktuara të shpenzimeve vetëm për të lehtësuar pozitën e palës debitore dhe ruajtjes së dinjitetit të tyre. Lidhur me pretendimin për dërgimin e shkresave, përbaruesi privat shton se kishte dërguar shkresat në adresën që kishte në dispozicion, kishte kërkuar të dhëna plotësuese në ARBK, kishte shkuar edhe personalisht për të shikuar ku gjindej vendndodhja e palës ankuese, kishte bërë kontrolle shtesë lidhur me adresën në llogarite bankare dhe pas gjitha përpjekjeve nuk ka pasur mundësi të sigurojë të dhëna shtesë në ATK lidhur me adresën e palës ankuese. Pasi gjitha përpjekjet për të siguruar të dhëna tjera kishin rezultuar të pasuksesshme, si opsion i fundit, sipas përbaruesit, ai në përputhje me ligjin ka bërë afishimin e shkresave të lëndës në tabelën e shpalljeve në zyrën e tij.

Komisioni gjatë procedurës së administrimit të provave ka lexuar: Certifikatën- Deklarues i TVSH-së; Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit në ARBK; Faturën e datës 08.08.2019; faturën e datës 02.07.2020; faturën e datës 28.05.2020; Informatën mbi Biznesin nga ARBK; Propozimin për Përbarim i datës 28.05.2020; Fletëdërgesat për dorëzim personal; konkluzionin e datës 11.06.2020; urdhërin për dërgimin e të dhënave bankare dhe bllokimin e atyre llogarive, e datës 22.06.2020; shënimin zyrtar të datës 22.06.2020; shënimin zyrtar të datës 02.07.2020; urdhërin për transferimin e të hollave të datës 02.07.2020; urdhërin për deblokimin e llogarive bankare të datës 02.07.2020; konkluzioni e datës 03.07.2020; pasqyra e shpenzimeve e datës 03.07.2020; korrespondencat elektronike.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se gjendja faktike e përsikruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të saktë dhe se përbaruesi nuk ka kryer veprë disiplinore.

Komisioni gjen se përbaruesi kishte ndërmarrë veprime për të siguruar adresën e saktë të palës debitore. Fakti se rrugët nuk përmbajnë emra dhe numra të saktë të adresave, nuk mund t'i atribuohen përbaruesit privat si lëshime. Përbaruesi kishte kërkuar informacione lidhur me

adresën e palës ankuese në disa burime, siç vërtetohet edhe nga provat në shkresat e lëndës. Edhe pse pala ankuese pretendon që adresa e tyre ishte në të dhënat e ARBK-së, bazuar në shkresat e lëndës, përmbartuesi privat kishte bërë kërkimë pikërisht në ARBK. Saktësisht në atë adresë të palës ankuese, e cila është e regjistruar në të dhënat e ARBK-së, ishin dërguar shkresat e lëndës nga ana e përmbartuesit privat. Megjithatë, dërgesat e dërguara në atë adresë kishin rezultuar të pasuksesshme. Përmbartuesi privat kishte ndërmarrë edhe veprime shtesë për të siguruar informacione për adresën e palës ankuese duke kontrolluar të dhënat lidhur me adresën e palës ankuese edhe në ATK dhe Regjistrin e Llogarive Bankare, dhe në të gjitha burimet e informimit, adresa rezultonte e njëjtë për palën ankuese. Vetëm pasi gjitha përpjekjet e përmbartuesit privat kishin rezultuar të pasuksesshme përmbartuesi privat kishte bërë afishimin e shkresave të lëndës në tabelën e shpalljeve në zyrën e tij. Rrjedhimisht, Komisioni nuk gjen shkelje disiplinore siç pretendohet nga ana e palës ankuese. Tufje, përmbartuesi privat kishte liruuar palën ankuese nga një shumë e shpenzimeve përmbartimore, e cila nuk kontestohet as nga ana e palës ankuese, që tregon se jo vetëm që përmbartuesi nuk kishte cënuar dinjitetin e palës ankuese por realisht, i kishte lehtësuar asaj barrën për shpenzimet. Për sa i përket asaj që pala ankuese, si rezultat i veprimeve të përmbartuesit privat kishte humbur mundësinë e paraqitjes së prapësimit. Komisioni vlerëson se pala ankuese këto pretendime mund t'i adresoj në gjykata përmes shfrytëzimit të mjeteve juridike në dispozicion. Komisioni nuk është instancë tjetër shtesë e procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palën adresojnë pretendimet ligjore për të cilat parimisht vendos gjykata. Rrjedhimisht, Komisioni, vlerëson se pretendimi i palës ankuese lidhur me paraqitjen e prapësimit, është i pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT**  
DPL nr 15./2020, datë 25.08.2020

Kryesues i Komisionit Disiplinor  
Adnan ISUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.